



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 70/ 2011**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muarrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 12.01.2011, mori këtë:

## **V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

## **A r s y e t i m**

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 10.01.2011, nga subjekti politik LDK, me te cilën pretendohet se në Qendrën e Votimit 3008a/03 vëzhguesja nga radhët e e subjektit politik PDK, Fidajete Morina e cila ka qenë vëzhguese në Vendvotimin 04 është lejuar që të votoj pa dokument valid të identifikimit dy herë: për vete dhe për nënën e saj. Këtë e ka lejuar kryesuesi i KVV Izet Morina, përfaqësues i PDK-së. Parashtruesi i ankesës si provë e ka bashkangjitur deklaratën e vëzhguesit të LDK-së Durim Krasniqi. Më këtë parashtruesi i ankesës konsideron se është bërë shkelje e ligjit dhe kërkon nga PZAP-i të marrë masat e parapara ligjore.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

- (b) *një përshkrim të hollësishëm, duke përfshirë datën, kohën dhe vendin e shkeljes së pretenduar;*

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit;*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoj shkresat e lëndës gjeti se;

**- ankesa është e pabazuar.**

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesë janë të pabazuara nga shkaku se nuk janë ofruar dëshmi për të besuar se kanë ndodhur shkelja e tillë. Për më tepër, parashtruesi i ankesës nuk ka specifikuar vendin e shkeljes së pretenduar siç përcaktohet me nenin 3.6 pika b) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, dhe kohën e saktë të ndodhjes së shkeljes së supozuar. Prandaj PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**

A nr. 70/2011 më datën 12.01.2011

